



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Për :	Begzad Sinani, Kryetar i Komunës së Kamenicës Bajram Dërmaku, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Cc:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Departamenti Ligjor dhe i Monitorimit të Komunave/ MAPL
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së.
Nga:	Shkëlqim Jakupi, U.D. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së Kamenicës
Lloji i aktit:	Vendim
	Datë: 10/05/2017 020/712

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësit Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 01-20987 për këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të personit fizik
I miratuar më datë më datë: 27.04.2017
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08.05.2017

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si me sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural *është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi* dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Za:	Begzad Sinani, gradonačelnik opštine Kamenica Bajram Dermaku, predsedavajući Skupštine opštine Kamenica
Kopija:	Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini Pravno odeljenje i nadgledanje opština, MALS
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, per! Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a
Od:	Shkelqim Jakupi, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i nadgledanje opština, MALS Data: 10.05.2017 Br. 020-712
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Kamenica
Vrsta akta:	Odluka

Poštovani gradonačelniče,  
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

Odluka 01-20987 za razmenu opštinske nepokretne imovine sa nepokretnom imovinom fizičkog lica.
Usvojena dana: 27.04.2017. godine
Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 08.05.2017. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt sa proceduralnog aspekta **u skladu sa odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvoditi pravni efekat. Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo dalje objašnjenje u vezi sa ovom procenom.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo


REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLICA KOSOVA  
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETARIT  
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Opstina Kamenica  
Kamenica Municipality

Sh. U. 01 Nr. 20987  
Br. 20987

Nr. i faq. 2 Data: 05/05  
Br. str. Datum: 2017

KAMENICEJA



Kuvendi Komunal Kamenicë  
Me: 03.05.2017

Në bazë të nenit 11 të Ligjit për Dhënie të Shfrytëzimit dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtëshme Komunale, nenit 21 të Rregullorës së ORK-së nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies të Shfrytëzimit dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtëshme të Komunës, nenit 12, paragrafi 2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenit 7.2.b dhe nenit 46 paragrafi 46.2 të Statutit të Komunës së Kamenicës, shkresës-Ekstrakt nga PZHK- Sh.06. Nr.19, dt. 27.01.2016 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, sipas kërkesës nr. 37791/2015 të datës 15.12.2015 e parashtruar nga Abedin Maliqi-Drejtor i Shkollës Fillore "Hasan Prishtina" nga Busavata, Vendimit Sh.02 nr.17262 dt. 07.04.2017 nga Kryetari i Komunës për pranimin formal të kërkesës, Kuvendi Komunal në Kamenicë, që në seancën e vet të rregullt të mbajtur më: 27.04.2017 mori këtë:

**V E N D I M**  
**MBI KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTËSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTËSHME TË PERSONIT FIZIK**

**I**

Miratohet vendimi mbi këmbimin e pronës së paluajtëshme të Komunës nga njëra anë, dhe pronës private në pronësi të Gani Destan Maliqi nga Gjilani, nga ana tjetër dhe ate në këtë mënyrë: pjesa e ngastrës kadastrale nr.P-71107009-00850-0, në vendin e quajtur "Melishte", në sipërfaqe prej 2500m<sup>2</sup>, cila në zyrën Komunale Kadastrale në Kamenicë evidencohet në Çertifikatën nr.4397/2015 dt.18.12.2015, në emër të P.SH. Kuvendi Komunal, për Z.K. Busavatë, këmbëhet me ngastrën kadastrale nr. P-71107009-00942-0, në vendin e quajtur "Te Shkolla", në sipërfaqe prej 3491m<sup>2</sup>, e cila në zyrën Komunale Kadastrale në Kamenicë evidencohet në Çertifikatën nr. 4395/2015 dt.18.12.2015 Z.K.Busavatë, në emër të Gani Destan Maliqi nga Gjilani, rruga "Memini Beqiri"-Gjilan.

**II**

Këmbimi bëhet për interes publik komunal-ndërtimi i objektit të ri shkollor, tereneve sportive dhe hapsirave gjelbruese për nxënësit e shkollës i arsyetuar nga Drejtori i Shkollës -Busavatë në kërkesën nr. 3779/2015 dt. 15.12.2015, dhe Ekstraktit nga PZHK-ja Sh.06. nr. 19. dt. 27.01.2016 nga DUPH-Sektori i Planifikimit. Ekspertët e DUPH-së në bashkëpunim me DPKGJ-ja konstatuan se komuna nuk ka parcela tjera që janë të ërshatëshme për këtë qëllim. Realizimi i projektit-terene sportive dhe hapsirave gjelbruese, është në harmoni me Planin Zhvillimor të Komunës, i financuar nga buxheti i Komunës dhe donacione tjera.

**III**

Pronari i paluajtëshmërisë private Gani D Maliqi, shprehë vullnetin e lirë dhe ofron nga sipërfaqja e tërësishme prej=3491 m<sup>2</sup>, që 991 m<sup>2</sup> i jep falas në emër dhe interes të Komunës, kurse për S=2500 m<sup>2</sup> kërkon këmbimin tokë me tokë në proporcion 1m<sup>2</sup> x 1 m<sup>2</sup>.

**IV**

Komuna duhet të e siguroi një raport vlerësues të pavarur të vlerës së tregut të lirë të pronës komunale e planifikuar për këmbim, vlerësim i cili bëhet nga Ministria e Financave-Departamenti i Tatimit në Pronë-Zyrja për vlerësimin e Paluajtëshmërive-ku do të bëhen publike rezultatet për pronat e këmbyerë, vlera e përafërt si dhe emrin e personit të pronës private që do të bëhet këmbimi.

**V**

Kryetari i Komunës do të kujdeset për procedurat e nevojshme lidhur me hartimin, nënshkrimin dhe vërtetimin e kontratës mbi ndërrimin e paluajtëshmërive, në mes të Komunës së Kamenicës nga njëra

HYRESE-ULAZNA-INCOMING  
REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVES/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarsivo Lokalne Samouprave i Administracije  
Ministry of Local Government Administration

Data  
Datum  
Date  
08.05.2017

Njësia organizative	Nr i Landës	Shifra	Vlera
- 3 -	020-712		

anë dhe Gani D Maliqit, nga ana tjetër, dhe ate: 2500 m<sup>2</sup> tokë private e Gani Destan Maliqit të këmbehet me 2500 m<sup>2</sup> tokë Publike Komunale për Z.K.Busavatë.

#### VI

Zbatimin e këtij vendimi do të bëjë Drejtoria për Pronësi Kadastër dhe Gjeodezi në Kamenicë e cila do të bëjë regjistrimin e pronave dhe të drejtën e pronësisë mbi këto paluajtëshmëri në Regjistrat e të Drejtave të Pronave të Paluajtëshme-SIKTK, kurse për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës.

#### VII

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë par regjistrimit në zyrën e protokolit të MAPL -së dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**Këtij vendimi i bashkangjiten:** Ekstrakti nga PZHK- Sh.06. Nr.19, dt. 27.01.2016 nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Kërkesën Nr. 37791/2015 të datës 15.12.2015 e parashtruar nga Abedin Maliqi-Drejtor i Shkollës Fillore "Hasan Prishtina" nga Busavata, Vendimit Sh.02 nr.17262 dt. 07.04.2017 nga Kryetari i Komunës për pranimin formal të kërkesës.

**Vendimi i dërgohet:** Kryetarit të Komunës, Kryesuesit, MAPL-së, DPGJK-së, DUPH-së, DFB-së, Shërbimit Profesional, Zyrës së Përkthimeve dhe QSHQK-arkivit.

